



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
NËNKOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 26.2.2025

Nr: 211

Ora: 18:00

VENDIM

PËR

MIRATIMIN E RAPORTIT MBI GJETJET KYÇE TË PROCESIT TË KRYQËZIMIT TË TË DHËNAVE ELEKTRONIKE DHE BIOMETRIKE TË MBLEDHURA NGA PAJISJET ELEKTRONIKE TË IDENTIFIKIMIT TË ZGJEDHËSVE, NË ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË HIMARË, TË DATËS 4 GUSHT 2024

Në mbështetje të neneve 14, 19 pikat 1, shkronja “n”, e 2, dhe pika 4 e nenit 167/2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSIM:

1. Miratimin e raportit mbi gjetjet kyçe të procesit të kryqëzimit të të dhënave elektronike dhe biometrike të mbledhura nga pajisjet e identifikimit elektronik që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Të bëhet kallëzim pranë organit të prokurorisë për shkeljet e konstatuara sipas listës në raportin e kryqëzimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Lealba PELINKU

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 26.2.2025 Nr: 211
Ora: 18:00



“Për miratimin e raportit mbi gjetjet kyçe të procesit të kryqëzimit të të dhënave elektronike dhe biometrike të mbledhura nga pajisjet e identifikimit elektronik në zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024.”



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

RAPORT

MBI GJETJET KYÇE TË PROCESIT TË KËQYRJES TË TË DHËNAVE ELEKTRONIKE DHE BIOMETRIKE TË MBLEDHURA NGA PAJISJET E IDENTIFIKIMIT ELEKTRONIK NË ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË HIMARË TË DATËS 4 GUSHT 2024

Hyrje

Bazuar në nenin 14, pikën 1, shkronja “c” dhe “n” dhe pikën 2 të nenit 19, nenin 23, pikën 8 të nenit 167/2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të kryqëzimit të të dhënave elektronike dhe biometrike të mbledhura nga pajisjet e identifikimit elektronik, të cilat u aplikuan gjatë zgjedhjeve të pjesshme për kryetarin e bashkisë Himarë, datë 4 Gusht 2024. Procesi i verifikimit paszgjedhor të kryqëzimit të të dhënave ka për qëllim të evidentojë rastet e dyshuara të zgjedhësve që kanë tentuar apo mund të kenë votuar më shumë se një herë në të njëjtën qendër votimi apo në një apo disa qendra të ndryshme.

Pas përfundimit të këtij procesi, stafi i KQZ-së vijoi më pas me përpunimin dhe analizimin e të dhënave për përgatitjen e këtij raporti përmbledhës mbi problematikat, tipologjitë dhe llojet e shkeljeve të konstatuara.

1. MBLEDHJA E TË DHËNAVE DHE KRYQEZIMI

Përshkrim i sistemit të implementuar

Sistemi Elektronik i Identifikimit të Votuesve përbëhet nga 3 komponentë:

PEI, Pajisja Elektronike e Identifikimit; nje pajisje e integruar, portabël dhe e specializuar për zgjedhje, e cila përmban listën elektronike të zgjedhësve me te gjithë komponentët e nevojshëm për të bërë të mundur një proces identifikimi të sigurt.

VIUClient; programi i specializuar për identifikimin e zgjedhësve i instaluar ne Pajisjen Elektronike te Identifikimit.

SEIV, Sistemi Elektronik i Identifikimit te Votuesve (server), i cili përbehet nga 2 komponentë:

CVIS Sistemi Qendror i Identifikimit të Votuesve, i cili bën të mundur përgatitjen dhe

konfigurimin e PEI.

ABIS Sistemi i Automatizuar i Identifikimit Biometrik, i cili menaxhon procesimin e të dhënave biometrike, deduplikimin dhe detektimin e rasteve të dyshuara si votim i dyfishtë/shumëfishtë.

Pas zgjedhjeve, çdo Pajisje Identifikimi u kthye në magazinat qendrore të KQZ-së për konsolidimin e të dhënave. Informacioni i mbledhur nga pajisjet e identifikimit u qendërzua në serverin SEIV, duke populluar databazën CVIS në nivelet hierarkike, sipas shpërndarjes gjeografike.

Pas procesit të konsolidimit të të dhënave, ABIS filloi procesimin e të dhënave, duke kryqëzuar çdo identitet kundrejt 8681 votuesve të identifikuar gjatë ditës së zgjedhjeve të datës 4.8.2024.

Pas procesimit, ABIS prodhoi rastet e cilësuar nga sistemi si “të dyshimta”, nga të cilat 3 (tre) u konfirmuan nga stafi i trajnuar i KQZ-së si të qenësishme.

2. KONSTATIME DHE PROBLEMATIKA

Në këtë kre janë analizuar dhe janë raportuar në mënyrë sintetike problematikat apo treguesit domethënës me gjetjet kyçe të këtij procesi.

- GJETJET E PROCESIT TË KRYQËZIMIT TË TË DHËNAVE

Bazuar në rezultatet e kryqëzimit të të gjitha shenjave të gishtrinjëve të depozituara në të gjitha PEI të cilat kane qenë funksionale dhe janë përdorur për identifikimin e zgjedhësve gjatë ditës së votimit, kane rezultuar 3 raste të lidhura me 6 identifikime. Prej tyre është vërejtur një tipologji rasti i evidentuar si më poshtë:

a) **Shenja gishti unike të cilat janë skanuar 2 herë. Pra 1 shenjë gishti e lidhur me 2 nr. personal të ndryshëm**

Bazuar në rezultatet e kryqëzimit të të gjitha shenjave të gishtërinjëve të konsoliduara në sistem, janë identifikuar 3 raste të evidentuara. Që do të thotë se 3 shenja gishtash (tre zgjedhës) janë depozituar nga 2 herë secili për Identitete të ndryshme që përbëjnë 6 total raste të dyshimta. Pra e njëjta shenjë gishti është skanuar nga Pajisjet Elektronike të Identifikimit në orare të ndryshme për 2 numra personalë të ndryshëm, domethënë 1 shenjë gishti lidhet me 2 numra personalë të ndryshëm ose, në rastin konkret, 3 shenja gishtash lidhen me 6 identifikime.

3. REKOMANDIME

Në përfundim të procesit të kryqëzimit dhe analizimit të të dhënave si dhe të problematikave të shfaqura gjatë periudhës zgjedhore dhe sidomos gjatë ditës së zgjedhjeve, duke marrë në konsideratë problematikat e evidentuara dhe të përcjella edhe në këtë raport, por jo vetëm, rekomandohet marrja e masave organizative si zbatimi efektiv i masave ndëshkuese ndaj administratës zgjedhore të nivelit të tretë, të cilët nuk zbatojnë rregullat që lidhen me identifikimin e sigurt të zgjedhësit dhe shmangien e votimit të shumëfishtë. Këtë masa synojnë rritjen e efikasitetit dhe vendimmarrjes së administratës zgjedhore. Njëkohësisht për shkeljet e konstatuara rekomandohet të bëhet kallëzim në prokurori.

Rekomandime:

Gjatë thirrjes për aplikim për operatorë, duke patur parasysh zonat me QV ku nuk ka aplikime sipas dhe analizave historike në zgjedhjet e shkuara të organizohen takime paraprakisht me dekanatet e

Universiteteve të vendit për të rekrutuar operatorë me studentë të interesuar në ato zona.

Manualet dhe materialet trajnuese si dhe procedurat dhe dokumentacioni i cili përdoret nga KQV dhe KZAZ duhet të thjeshtohen

Implementimi i sistemeve teknologjike ERP dhe CRM me Contact Center për të facilituar statusin e vendndodhjen e aseteve (PEI) nëpërmjet ERP dhe menaxhimi efektiv i operatorëve e ngritja e një qendre shërbimi telefonik për të ofruar suport ndaj të gjithë aktoreve të perfshire me Identifikimin Elektronik nëpërmjet sistemit CRM.

Rishikim i software të Pajisjes së Identifikimit dhe ndryshime në raportet e gjeneruara sipas rekomandimeve nga grupet e punës së auditeve, me qëllim thjeshtimin e përdorimit dhe shmangien e rasteve të mosvënies në punë.

Investigim i mundësisë së përdorimit të shenjës së gishtit për të kryer identifikimin biometrik të zgjedhësve, e plotësuar me kontroll të dokumentit fizik të identifikimit. Ky kontroll do të shmangte ose zvogëlonte pothuajse tërësisht mundësinë votimit familjar ose votimit për një person tjetër (me përjashtim të rasteve ku administrata zgjedhore me vullnet të plotë e lejon, pavarësisht sinjalizimit të pajisjes) që në momentin e votimit gjatë procesit zgjedhor e jo në formë kontrolli pas-zgjedhor, siç ndodh tani.

Referim pranë organeve ligjzbatuese:

Në lidhje me rastet e evidentuara nga procesi i kryqëzimit të të dhënave biometrike, sugjerohet referimi drejt prokurorisë për rastet:

Shenja gishti të skanuara 2 herë. Shenja gishti unike të cilat janë skanuar 2 herë. Pra 1 shenjë gishti e lidhur me 2 nr personalë të ndryshëm. Paraqitet nevoja për t'u verifikuar nëpërmjet pamjeve filmike nëse ka qenë tentativë e operatorëve për të përshpejtuar procesin e identifikimit në rastet kur ka pasur vështirësi për skanimin e shenjave të gishtave (mosha e zgjedhësit, dëmtime të lëkurës), apo nëse ka patur votim familjar ose për persona të tjerë.

Lista me rastet e evidentuara nga procesi i kryqëzimit të të dhënave biometrike 04.08.2024

NR	Qarku	Bashkia	QV	Iniciale
1	Vlore	Himarë	4569/00	A.L
2	Vlore	Himarë	4569/00	K.L
3	Vlore	Himarë	4562/00	P.R
4	Vlore	Himarë	4562/00	E.V
5	Vlore	Himarë	4600/00	A.M
6	Vlore	Himarë	4600/00	Sh.M